



KONTRATA

Me datë 08/12/2020 në mes të:

KOMUNA E PRISHTINËS, rruga: UÇK 2, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njërën anë dhe

"Kater A" SH.P.K., nga Prishtina– Rruga Ulpiana e Re, P.N. Hajvali, Prishtinë, ", me numër të regjistrimit të biznesit 810035297 dhe me numër fiskal 810035297 përfaqësuar nga Arsim Selimi– Drejtorë në tekstin e mëtejme ("Kontraktuesi"), janë pajtuar si në vijim:

TITULLI I KONTRATËS: "Furnzimi me inventar për kuzhinen e çerdhes në Besi"

Numri i Prokurimit: 616 20 164 136

Neni 1 Lënda

- 1.1 Lënda e kontratës do të jetë "Furnzimi me inventar për kuzhinen e çerdhes në Besi"
- 1.2 Kontrata hynë në fuqi me nga data e caktuar në planin e menaxhimit nga menagjeri i kontratës..
- 1.3 Afati kohor i performances nuk mund të jetë më shumë se 20 ditë nga data e marrjes së urdhëreses.
- 1.4 Vendi do të jetë çerdhja në Besi –Komuna e Prishtines.
- 1.5 Incotermi i aplikueshëm do të jetë DDP¹ (Detyra e Dërguar e Paguar).

Neni 2 Ligji i aplikueshëm

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë sipas Nenit 40 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

Neni 3 Çmimi

- 3.1 Çmimi total i kontratës do të jetë: **2.230,00€**; (Dy mijë e dyqind e tridhjet euro e zero euro cent).
- 3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve gjatë ekzekutimit

¹ DDP – Detyra e Dërguar e Paguar- Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

të kontratës (në përjashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtrohen ndryshimit të çmimit sipas berzës përkatëse, nëse aplikohet).

Neni 4 Pagesat

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

[Autoriteti Kontraktues do të paguaj shumën totale të pagesës pas pranimit të tërë dërgesës]

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

Neni 6 Kualiteti

6.1 Kualiteti i *[furnizimeve]* duhet në të gjitha aspektet të plotësoj specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

Neni 7 Garancioni

7.1 Garancioni do të mbetet valid për 12 muaj, pas pranimit të *[furnizimeve]*

Neni 8 Vonesat në ekzekutim

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin *[t'i dorëzojë ndonjë ose të gjitha mallrat]* *[të realizojë ndonjë ose të gjitha shërbimet]* *[të kryej ndonjë ose të gjitha punët]* brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së *[furnizimeve]* *[punëve]* *[shërbimeve]* të para dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

Neni 9 Inspektimi dhe testimi

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

Neni 10 Nën-kontraktimi

10.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontrakttojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f).

Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judicata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korrupsion, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsye që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila palë mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit të kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në [specifiko gjykatën kompetente] në pajtim me ligjin e Kosovës.



Neni 14 Komunikimi



14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin e identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

E hartuar në gjuhën [Shqip]² në katër origjinale, tri origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.

Për Operatorin Ekonomik

Për Autoritetin Kontraktues

Emri:	ARRIM SELIMI	Emri:	Zekë Bardhaj
Pozita:	DREKTOR	Pozita:	Udhëheqës i Departamentit të Prokurimit
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	08.12.2020	Data:	08-12-2020
Vula:		Vula:	



² Gjuha do të jetë gjuha e përdorur nga tenderuesi në tenderin e tij.

KONTRATË PËR FURNIZIMIN ME KUZHINË NË QENDHËN "SHTEPIA MAQIKE" BESI - PRISHTINË


PARAMASA DHE PARALLOGARIA



Nr.	Përshkrimi	Njësia	Sasia	Çmimi	Shuma
-----	------------	--------	-------	-------	-------


Vërejtje: Duhet të bëhen verifikimet dhe të gjitha matjet e nevojshme të hapësirës për punimin e inventarit. Për ngjyra dhe tekstura të konsultohet paraprakisht organi mbikëqyrës. Modeli i produkteve duhet të jetë i ngjashëm si në foto ose sipas përshkrimit.

1	<p>Furnizimi, blerja dhe montimi i kuzhinës në formë "L", me dimensione 255x60cm në njërin anë, kurse në anën tjetër 170x60cm, me lartësi h=90cm të pjesës së poshtme dhe pjesës së sipërme me dimensione h=72cm; përbëhet prej lavamanit, dollapve, paisjet përcjellëse. Materiali i përdorur është Inox per pjesën e lavamanit, dollapve, paisjet dollapin me pllakë zdrukthi melaminë, pllaka me ngjyrë X, me t= 18mm dhe pllakë e presuar me t=18mm me densitet (600-700 kg/m³), (ngjyra dhe tekstura të konsultohen paraprakisht me organin mbikëqyrës). Kuzhina duhet të përmbajë minimalisht 3 fijoکا, cesmen, sifonin, gypat per uje te nxehte dhe te ftohte dhe te gjitha pjeset e nevojshme per funksionalizimin e saj. Të gjitha anët e pllakës së prerë duhet të kantoohen me shirit të të njëjtës teksturë (ABS) mekanizmi i dollavave duhet të jetë me mbijlje të butë. Mënyra e ngjiftjes (fiksimit të pllakave) propozohet nga prodhuesit varësisht prej teknologjisë së përdorur, gjithmonë në konsultë me organin mbikëqyrës. Derrasa e punes duhet te jete pllake kompakti 12mm e cila eshte rezistente ndaj lageshtise, nxehtesise dhe goditjes. Duhet te parashihet prejra e kompaktit per vendosjen e lavamanit dhe pllakes se shporetit si dhe te behet polirimi i tehave te derases. Tekstura duhet te konsultohet me organin mbikeqyrës.</p> <p>Pozicioni përfshinë të gjitha materialet e imëta (dorëzat, distancerat, bravat, etj) modelet e të cilave përzgjidhen nga organi mbikëqyrës, si dhe punët tjera të nevojshme që ky aktivitet të jetë i përfunduar, poshtu duhet të prezentohen një prototip dhe të marr</p>	Copë	1	€ 900.00	€ 900.00
---	--	------	---	----------	----------

<p>2</p> <p>Furnizimi, blerja dhe montimi i aspiratorit të jashtëm për kuzhinë me këto specifika: * Aspirator 60cm (montues) * Fuqia thithëse: 650 m3/h * Fuqia e motorit: 190 W * Ndriqimi LED 1x2 W * Niveli i zhurmës: 52 dB</p>	Copë	1	€ 50.00	€ 50.00
<p>3</p> <p>Furnizimi, blerja dhe montimi i enëlarësës montuese 60cm me këto specifika: * Klasa energjise: A+ * Kapaciteti: 13 Sete * Nr. Programe: 6 * Shpenzimet e energjise: 295 kWh /vit * Përmasat: 82x59.8x55cm * Niveli i zhurmës: 53 dB</p>	Copë	1	€ 300.00	€ 300.00
<p>4</p> <p>Furnizimi, blerja dhe montimi i lavamanit inox për kuzhinë me një thellësi dhe një pushimore.</p>	Copë	1	€ 50.00	€ 50.00
<p>5</p> <p>Furnizimi, blerja dhe montimi i bateri-së së inoxi për kuzhinë me të gjitha pajisjet përcjellëse për montim. Furnizimi, blerja dhe montimi i frigoriferit të kombinuar (montues) me këto specifika: * Klasa energjise: A+ * Kapaciteti neto: 265 L * Kapaciteti i frigoriferit: 199 L * Kapaciteti i frizit: 66 L * Shpenzimet e energjise: 275 kWh /vit * Përmasat: 177.5x55x56.2cm * Niveli i zhurmës: 40dB</p>	Copë	1	€ 20.00	€ 20.00
<p>Copë</p> <p>1</p> <p>€ 350.00</p> <p>€ 350.00</p>				

	<p>Furnizimi, blerja dhe montimi i furrës montuese me këto specifika:</p> <ul style="list-style-type: none"> * Furrë montuese * Multifunksionale * Klasa energjise: A * Kapaciteti: 71 L * 8 Funksione * Grill, Ventilator, pjekje 3D * Telescopic (raft tërheqës) * Paneli i kontrollit: Mekanik * Kohëmatës digital <p>* Përmasat: 59.5x59.4x56.7cm</p>					
	<p>Furnizimi, blerja dhe montimi i pllakës qeramike (montuese)</p> <ul style="list-style-type: none"> * Pllakë qeramike (montuese) * 4+2 sipërfaqe të ngrohjes * Zona ekspres * Komandim digital * Indikator i nxehësisë * Child lock <p>* Përmasat: 58x5.5x51cm</p>					
6	<p>Furnizimi, blerja dhe montimi i shportës për kuzhinë 35L e mblyllur. Materiali: metal, polypropylene, antikoroduese. Ngjyrë hiri. Modeli sipas fotos.</p> 	Copë	1	€ 100.00	€ 100.00	
				Totali:	€	2,230.00



KATER A
OFFICE FURNITURE

NRB	810035297
NRF	810035297
TVSH	330359712

Për: KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES

Lënda: Furnizimi me inventar për kuzhinen e çerdhes në Besi

NRP: 616-20-7377-1-3-6

Deklarate e Specifikimit Teknik

Përmes kësaj letre ne KATER A SH.P.K deklarojme se Mallerat e ofruara jane ne perputhje të plotë me specifikat dhe kerkesat ne Anex 1 ne Dosje te Tenderit


Arsim Selimi

Kater A SH.P.K

Data: 16.11.2020

Nënshkrimi





KATER A
OFFICE FURNITURE

NRB	810035297
NRF	810035297
TVSH	330359712

Për: KUVENDI I KOMUNES SE PRISHTINES

Lënda: Furnizimi me inventar për kuzhinen e çerdhes në Besi

NRP: 616-20-7377-1-3-6

DEKLARATË PËR

AFATI I LIFERIMIT

Përmes kësaj letre ne KATER A SH.P.K garantojmë se nëse shpërblehemi me kontratë do të bëjmë liferimin dhe montimin e të gjitha pajisjeve të cekura në kontratën me numër të lartë cekur të prokurimit në afat prej 20 ditë nga nënshkrimi i kontrates

Arsim Selimi

KATER A SH.P.K

Data: 16.11.2020

Nënshkrimi

